

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË

“KLESTI 2017” Sh.P.K.

Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot më 11.11.2022, unë Gentian Lika , shtetas shqiptar, lindur më 20.02.1982 banues në Lac, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I20220120V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “për shoqëritet tregtarë” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 ‘Për tregtarët dhe Shoqëritet Tregtare’ i ndryshuar
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë
-

KREU I

Themeli, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni I

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit, Selia

Sot, më 11.11.2022 unë, themeluesi i mësipërm, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar “KLESTI 2017”.

Gentian Lika


Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

Import-eksport, ,tregetim perpunim,montimin e aluminit,plastikes, aksesoreve te aluminit,xhamit dhe elementeve te lidhura me to.Rikonstruksin fasadave te objekteve te ndryshme.

Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme, të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.

Neni 4

Selia

*Selia e shoqërisë ndodhet në adresën **LAC Lagjja nr.5, Rruga Kryesore, Ndertese private kati 1, Zk.2365, nr. Pasurie 139/57.***

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.



Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

*Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe zotërohet tërësisht nga ortaku themelues **Gentian Lika** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 LEK që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

Kontributi i ortakut është në para.

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkjesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njejtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.


Kreu III
Organet vendimmarrëse dhe drejtuese
Neni 8
Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve
- d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar



- e. Përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d tē kësaj pike.
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raportve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Rior organizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve tē asamblesë
- m. Shpérndarjen e fitimeve vjetore
- n. Çështje tē tjera tē parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund tē përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë tē një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund tē veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund tē jepet vetëm për një mbledhje tē asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njejtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet tē përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet tē gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është éthirrur sipas pikës 1 tē këtij nenit, ajo mund tē marrë vendime tē vlefshme vetëm nëse tē gjithë ortakët janë dakort për tē marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gentian Lika". Below the main signature is a smaller, stylized signature or mark.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithsme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njejin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruar të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë; emerimin e administratorëve; emerimin e shkarkimin e likujdusve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; mitarimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.



Gentian Lika

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonje detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jot ë përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqsohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Komëtare të Biznesit.

Personat e mëposhtëm caktohen si administrator të parë të shoqërisë për një mandate të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- Z.Gentian Lika, shtetas shqiptar, lindur më 20.02.1982, banues në Lac, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I20220120V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.



Kreu IV

Viti finansiar – ekspertët

Neni 14

Viti finansiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor.

Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 dhjetor.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtua e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.


Kreu 5

Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likujdimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gentian Lika". The signature is fluid and cursive, with "Gentian" on top and "Lika" below it, separated by a diagonal line. There is also a smaller, less distinct signature or mark underneath.

nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës. Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likujdim e sipër”. Prishja e shoqëris tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit që janë emëruar nga Ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.

Neni 17

RiorGANIZIMI I SHOQErisë BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.



Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“KLESTI 2017” Sh.P.K.

Gentian Lika

